

VENDIM
Nr. 669, datë 15.11.2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1434, DATË 29.10.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I QENDRËS SË RE KOMBËTARE DISPEÇER, I ZYRAVE TË REJA TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST) SHA, DHE I DISPEÇERISË QENDRORE KASHAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozim të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1434, datë 29.10.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në listën e miratuar sipas pikës 1 shtohen pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, për interes publik, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Në pikën 3, sipërfaqja 20 935 (njëzet mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) m² ndryshon dhe bëhet 26 174 (njëzet e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) m².
 3. Në pikat 3 dhe 4, vlera prej 52 487 020 (pesëdhjetë e dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëzet) lekësh ndryshon dhe bëhet 54 834 092 (pesëdhjetë e katër milionë e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë.
 4. Shpronësimi, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të fillojë brenda muajit nëntor 2017.
 5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a., dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT NDËRTESA E RE E OST SHA,
QENDRA DISPEÇER DHE SIGURIA E QENDRES DISPEÇER

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë bujqësore, arë
Lloji i pasurisë së kulturës bujqësore që dëmtohet

Nr.	Pronësia										
	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit m ²	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera në lekë	Shënime
Bashkia Tiranë											
Njësia Administrative Kashar											
1	Rexhep	Shaban	Sula	Arë	2105	1/15	7375	3043	448	1,363,264	Kashar, Tiranë
2	Rexhep	Shaban	Sula	Arë	2105	1/18	4437	2196	448	983,808	Kashar, Tiranë